



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 311 Prot.

Tiranë, më datë 26.07.2024

**VENDIM**  
**Nr. 272, datë 26.07.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 26.07.2024:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e “Koncepti paraprak i disenjimit për ndërhyrje konservuese, strukturale dhe gjeologjike. Plane interpretimi dhe përmirësimi i eksperiencës së vizitorëve në Kalanë e Borshit” Monument Kulture i Kategorisë së I-rë me aplikues dhe zhvillues **"Cultural Heritage without Borders-Albania" me rekomandimin;**
    - Në projektin e zbatimit të parashikohet pozicionimi i infopoint në genplan;
  2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
  3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
  4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI



**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**